

**Z. Gjovalin Preçi** ka përfunduar studimet Universitare në Fakultetin Ekonomik në Degën e Planit në vitin 1985, si dhe studimet e nivelit “Master” në Universitetin Bujqësor të Kamzës, në profilin e Ekonomisë dhe Politikave Agrare në vitin 2005.

Nga viti 1986 deri në vitin 2006 ka kryer detyra të ndryshme në sektorin publik në nivel vendor dhe qendror, si Përgjegjës i Zyrës së Mbrojtjes Sociale, Kryespecialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Përgjegjës i Sektorit të Mbikëqyrjes në Inspektoratin e Mbikëqyrjes së Pensioneve Private pranë Këshillit të Ministrave etj.

Gjatë kësaj periudhe nuk kanë munguar angazhimet individuale në zbatimin e projekteve nga organizata të shoqërisë civile vendase dhe të huaja, si dhe me botime në revista shkencore e shtypin e përditshëm.

Në Kontrollin e Lartë të Shtetit ka filluar punë në muajin shkurt 2007 me detyrën e audituesit dhe më pas të Kryeaudituesit në Departament Auditimi.

Gjatë kësaj periudhe Z. Gjovalin Preçi është ngarkuar dhe me detyra të tjera si atë të Drejtorit të Departamentit, të Sekretarit të Përgjithshëm etj.

Aktualisht është në pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Gjatë kësaj eksperience të gjatë profesionale, Z. Preçi ka kryer një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit në lidhje me çështjet e auditimit të jashtëm në sektorin publik. Ai është pjesëmarrës dhe lektor në disa konferenca shkencore, si dhe ka publikuar një gamë të gjerë artikujsh në median e shkruar mbi auditimin, në dobi të mirëqeverisjes dhe mirëadministrimit të aseteve dhe pasurisë publike.